

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR  
“KELA & CO”**

Sot më datën **10/01/2024** Une Shtetasi:

❖ **Elkler Ademi** i datëlindjes **22/03/1987** Lindur dhe banues në **Fier, Lgj. 1 Maj** mbajtës i ID nr **035804277**,

Me dëshirë dhe vullnet të lirë dhe të plotë në mbështetje Në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” si edhe ligjit Nr9723 datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit” të ndryshuar, vendosa të formuloj këtë akt themelimi për një shoqëri tregtare private me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k) si më poshtë vijojnë .

**Neni 1. Emri**

Të formohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emrin **KELA & CO**

**Neni 2. Selia**

Shoqëria selinë e saj do ta ketë në adresën: **Fier, “Lgj. 1 Maj, Rr. Unaza Nuredin Alliu, Truall me nr pasurie 7/45 Z.K 8531 9301 “**

Me të drejtë hapje degësh, filjalesh e zyrash, përfaqësish në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

**Neni 3. Kohëzgjatja**

Shoqëria krijohet për një aktivitet me kohëzgjatje me shume se 10 vite. Ky afat mund të zgjatet por edhe mund të shkurtohet për rastet kur shoqëria do të shpërbëhet sipas përcaktimeve që do të pasqyrohen në statut.

**Neni 4. Themeluesit**

Themeluesit e shoqërisë janë:

❖ **Z. Elkler Ademi** i datëlindjes **22/03/1987** Lindur dhe banues në **Fier, Lgj. 1 Maj** mbajtës i ID nr **035804277 dhe numer personal I70322022V**

**Neni 5. Objekti**

Shoqëria tregtare private “**KELA & CO**” sh.p.k ka për objekt të veprimtarisë së saj ;

- **Aktivitet ne fushen e ndertimeve.** Ndertime Civile, ekonomike, publike dhe vepra arti. Ndertim Ujesjellesa dhe kanalizime. Investime ne ndertim per objektet e veta, investime ne fushen e turizmit (hoteleri, bar restorante etj). Veprimtari ne fushen e turizmit, me qellim jo vetem ngritjen por edhe shfrytezimin dhe zhvillimin e veprimtarive ne fushen e hotelerise, fshatrave turistike te pushimit, qendrave te argetimit, brenda dhe jashte vendit, si dhe te bleje, te marre dhe te jape me qera, te ndertoje apo te nxise ndertimin e tyre duke vepruar ne kete fushe apo me partnere te tjere
- **Rikonstruksione** te te gjitha llojeve, veshje fasadash. Mirembajtje e projektim i strukturave te zakonshme prej murature, tulla, guri, betoni, betonarmeje. Punime duralumini e punime pllaka, gipsi, shtrim veshjesh hidrotermoizoluese, shitblerje e objekteve te ndertimit etj
- **Tregtim i materialeve** te ndertimit, pllakave te te gjithave llojeve, plastikes, lendes drusore e mobiljeve te tualetit, por pa u kufizuar vetem ne keto; Import-eksport e tregti me shumice e pakice i artikujve te ndryshem te ndertimit, bojera, materiale rifinituarash, hidrosanitare sisteme ngrohje ftohje etj.

- **Vendosja ne dispozicion** te klienteles, ambjente te pershtatshme per te prezantuar mallrat tregtareve, mediatoreve dhe biznesmeneve te interesuar per shitblerjen e mallrave te ndryshem.

#### **Neni 6. Kapitali themeltar**

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është **28.100.000 (njetete e tete million e njeqind mije)** lekë formuar dhe nënshkruar nga ortaku i shoqërisë, i ndarë në 1 (një) kuotë. Shlyerja e kapitalit do të bëhet pas rregjistrimit në QKB. Ortakët e shoqërisë kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie në proporcion me pjesën e tyre, mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

#### **Neni 7. Fitimi**

Fitimi i shoqërisë i përket tërësisht ortakëve të saj **Z. Elkler Ademi**. Ky fitim do të disponohet lirisht prej tyre pasi të jenë shlyer më parë detyrimet tatuese fiskale dhe ato ndaj të tretëve.

#### **Neni 8. Organet vendimarrëse**

Organ vendimor në shoqëri është Asambleja e Përgjithshme, e cila është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet sipas parashikimeve të nenit 81 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “

#### **Neni 9. Veprimtari të shoqërisë**

Do të konsiderohen veprimtari e shoqërisë vetëm ato veprime Juridiko-civile që do të kryhen nga organet ose punonjësit e saj, conform disponimeve në statutin e saj dhe në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 10. Afatet e veprimeve ekonomike**

Si rregull, veprimet ekonomike të shoqërisë do të mbyllen më 31 Dhjetor të cdo viti. Përjashtim nga ky rregull do të bëhet kur e kërkon organi kompetent ligjor.

#### **Neni 11. Prishja dhe Likuidimi**

Shoqëria do të prishet / likujdohet sipas rasteve që do të përcaktohen në statutin e saj.

#### **Neni 12. Mosmarrëveshjet**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis personave pjesëmarrës ose jo në shoqëri, do të zgjidhen me mirëkuptim midis tyre. Në rast se kjo nuk arrihet, ato do të zgjidhen nga Gjykata kompetente sipas legjislacionit Shqiptar.

Ky akt, përpilohet në 4 kopje të barabarta në gjuhën shqipe dhe hyn në fuqi ditën e rregjistrimit të shoqërisë pranë QKB, një kopje e këtij Akt-Themelimi do të ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë tregtare “**KELA & CO**” sh.p.k

#### **Ortaku i Shoqërisë**

**Elkler ADEMI**

(Emër Mbiemër, Firmë)



**STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË**  
**KUFIZUAR**  
**“KELA & CO”**

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1:**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, më **10/01/2024**, unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **KELA & CO**.

(2) Themeluesit e shoqërisë janë:

- ❖ **Z. Elkler Ademi** i datëlindjes **22/03/1987** Lindur dhe banues në **Fier**, Lgj. **1 Maj** mbajtës i ID nr **035804277** dhe numer personal **I70322022V**,

**Neni 2: Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm;


- **Aktivitet ne fushen e ndertimeve.** Ndertime Civile, ekonomike, publike dhe vepra arti. Ndertim Ujesjellesa dhe kanalizime. Investime ne ndertim per objektet e veta, investime ne fushen e turizmit (hoteleri, bar restorante etj). Veprimtari ne fushen e turizmit, me qellim jo vetem ngritjen por edhe shfrytezimin dhe zhvillimin e veprimtarive ne fushen e hotelerise, fshatrave turistike te pushimit, qendrave te argetimit, brenda dhe jashte vendit, si dhe te bleje, te marre dhe te jape me qera, te ndertoje apo te nxise ndertimin e tyre duke vepruar ne kete fushë apo me partnere te tjere
- **Rikonstruksione** te te gjitha llojeve, veshje fasadash. Mirembajtje e projektim i strukturave te zakonshme prej murature, tulla, guri, betoni, betonarmeje. Punime duralumini e punime pllaka, gipsi, shtrim veshjesh hidrotermoizoluese, shitblerje e objekteve te ndertimit etj
- **Tregtim i materialeve** te ndertimit, pllakave te te gjithave llojeve, plastikes, lendes drusore e mobiljeve te tualetit, por pa u kufizuar vetem ne keto; Import-eksport e tregti me shumice e pakice i artikujve te ndryshem te ndertimit, bojera, materiale rifinituarash, hidrosanitare sisteme ngrohje ftohje etj.
- **Vendosja ne dispozicion** te klienteles, ambjente te pershtatshme per te prezantuar mallrat tregtareve, mediatoreve dhe biznesmeneve te interesuar per shitblerjen e mallrave te ndryshem.

**Neni 3: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me shume se 10 vite pune

**Neni 4: Selia**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Fier, “Lgj. 1 Maj, Rr. Unaza Nuredin Alliu, Truall me nr pasurie 7/45 Z.K 8531 9301 “**



## Kreu II Kapitali

### Neni 5 Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është i perbere nga kontributi i ortakeve themelues me vlere 28.100.000 (njezete e tete million e njeqind mije) Lekë qe perben 100% te kapitalit dhe ndahet ne 1 (një) kuotë.
- (2) Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
1. Ortaku themelues **Z. Elkler Ademi**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **28.100.000** (njezete e tete milion e njeqind mije) leke që përben **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

### Neni 6:

#### Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### Neni 7

#### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU III

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqërisë qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:



- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 9

#### Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 10

#### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### Neni 11

#### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:



- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

### Neni 12 Përgjithshme nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.


### Neni 13 Administrimi

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 2 (dy) vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

- ❖ **Perparim Alliu** i datëlindjes 10-01-1976 Lindur dhe banues në **Fier, Lgj. Bishanake, Rr. Skenderbeu** mbajtës i ID nr **035790944** dhe numer personal **H60110015V**,

❖ **Specimeni e nënshkrimit**



### Neni 14 Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:



- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratores janë të detyruar të theasin Asambletë e Përgjithshme, në rastet kur:  
 -sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.  
 -shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 15 Përgjegjësia e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1.
  - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë



realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV Viti financiar-ekspertet**

##### **Neni 16**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 17**

##### **Ekspertet**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### **Kreu V Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

##### **Neni 18**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;





Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 19**

#### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

#### **Neni 20**

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

#### **Neni 21**

#### **Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqërise dhe te treteve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptare.

#### **ORTAKU**

#### **I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**\* KELA & CO \***

**Elkler ADEMI**

(Emër Mbiemër, Firmë)

